



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:074220

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06313641

AC-I-23-0275

Në ankesën e

Paditësi

B B nga Lipjani.

kundër

E paditura/Ankuesja

NSH "Fabrika e Letrës, Kartuçit dhe Ambalazhit", (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga, gjyqtar kryesues Mr.sc. Sahit Sylejmani, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0241 të datës 26 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-14-0241 i datës 26 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 14 janar 2014, në DHPGJS, paditësi, i cili fillimisht përfaqësohej nga avokati N G, parashtroj një kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin në vijim: AL) PRN022-0017 datë 11 dhjetor 2013, me të cilin i pjesërisht është aprovuar kërkesa kreditore e ankuesit, mbi pagat e papaguara për periudhën nëntor 2003 gjer korrik 2005, ashtu që nga shuma e kërkuar prej 2,354.00 Euro, është pranuar në shumë prej 911.05 Euro, gjersa shuma e mbetur e kërkuar prej 1,473.00 është refuzuar si e pabazuar, kërkesë kjo ndaj NSH "Fabrika e Letrës, Kartuqit dhe Ambalazhit" (në likuidim).

Paditësi të drejtën e tij mbi pagat e papaguara, për periudhën si më lartë të përshkruar, e mbështet në Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.2/2006 datë 17 korrik 2006. Sipas Aktgjykimit, paditësit i njihet e drejta në kompensimin e të ardhurave personale, në shumë totale prej 2,354.00 euro duke përfshirë edhe kamatën ligjore gjer në pagesën definitive. Paditësi tutje konsideron se Vendimi i AL konsiderohet si vendim joligjor.

Me një Vendim të tillë, paditësi ka pohuar se AL ka shkelur dispozitat ligjore të Rregullores 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë (nenin 14 dhe nenin 15). Nga gjitha arsyet paditësi propozon që gjykata ta prish Vendimin e AL dhe ta aprovoj kërkesën e tij kreditore, në shumën e kërkuar si dhe pagesën e kamatës. Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur: Kopja e Vendimit të AL, Kopjen e padisë, e parashtruar në Gjykatën Komunale në Lipjan, me 23 dhjetor 2005, Kopja e Vërtetimit, nr. 2/2000 datë 15 prill 2005, lëshuar nga NSH, mbi pozitën e tij si i punësuar, Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin e tij, avokat N G, Kopja e kërkesës kreditore, Kopja e Aktgjykimit, dhe Kopja e Aktvendimit, E.nr. 553/2006 datë 27 dhjetor 2007 për pezullimin e procedurës së ekzekutimit të Aktgjykimit.

Më 25 mars 2016, AKP ka parashtruar përgjigjen me të cilën e ka kundërshtuar ankesën si të pabazuar. Sipas AKP, AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e paditësit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se kërkesa për rishikim –ankesa e paditësit është e pas-afatshme pasi pranë gjykatës është parashtruar me 14 janar 2014. AKP gjithashtu pohon nuk ka ofruar argumente në favor kërkesës së tij, duke pretenduar se me kërkesë nuk ka parashtruar Aktgjykimin dhe AL me rastin e vlerësimit të kërkesës me të drejtë ka konstatuar borxhin e NSH ndaj tij. Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar

dhe Vendimi i AL të vërtetohet. Përgjigjes i janë bashkangjitur: Kopjet e parashtruara të dokumentacionit si pranë gjykatës nga ana e paditësit, dhe një kopje të regjistrit të punëtorëve të NSH.

Me 22 nëntor 2022, përfaqësuesi i paditësit dorëzoi një parashtresë mbi tërheqjen e kërkesës për rishikim- ankesës.

Me 08 shkurt 2023, paditësi me parashtresë, ka kërkuar përsheptimin e procedurës dhe vendosjes nga ana e gjykatës, lidhur me kërkesën e tij. Duke marr parasysh kërkesat e ndryshme, në njërin anë nga përfaqësuesi i paditësit dhe paditësit.

Me 14 shkurt 2023, Gjyqtari i Shkallës së parë lëshoi një urdhër për përfaqësuesin e paditësit dhe paditësin që të deklarojnë lidhur me parashtresat e tyre se a qëndrojnë pranë kërkesës për rishikim-ankesës apo dëshirojnë që kërkesa për rishikim-ankesa të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi me parashtresën e tij, e parashtruar pranë gjykatës me 21 shkurt 2023, thekson se qëndron pranë kërkesës për rishikim-ankesës.

Përfundimisht, përfaqësuesi i paditësit avokat N G, me parashtresën e tij të parashtruar me 23 shkurt 2023 deklaroi se revokon autorizimin për përfaqësimin e mëtutjeshëm të paditësit dhe shpjegoi dhe argumentoi arsyet e parashtresës së mëhershme mbi tërheqjen e kërkesës për rishikim, duke i bashkangjitur parashtresa shpjeguese.

Me 26 prill 2023, Shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-0241, e aprovon pjesërisht si të bazuar ankesën/kërkesën për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit, e Shfuqizon vendimin e AL PRN022-0017 të datës 11 dhjetor 2013, e Obligon Autoritetin e Likuidimit – AKP-në që paditësit, në emër të kompensimit të pagave të papaguara, ti paguhet shuma prej 2,354.00 Euro si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % t'i paguhet shuma prej 235.40 Euro, ndërsa Kërkesa e paditësit me të cilën kërkon kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, të shkaktuara pranë Gjykatës Komunale në Lipjan, në shumë prej 78.00 Euro, refuzohet.

Shkalla e parë ka arsyetuar se i paargumentuar është pohimi i AKP se kërkesa për rishikim-ankesa të konsiderohet si e pa-afatshme. Gjithashtu, i paargumentuar është pohimi i AKP se AL me rastin e vendosjes nuk e ka pasur si dëshmi aktgjykimin. Shkalla e parë ka konsideruar se e drejta e paditësit mbi pagat e pa-paguara buron nga Aktgjykimi i plotfuqishëm, sipas të cilit rrjedh obligimi i NSH që paditësit ti paguaj pagat e pa-paguara në shumë prej 2,354.00 euro, shumë kjo për periudhën e kërkuar. Me aktgjykim paditësi ka bazën ligjore, me të cilën i njihet një drejtë, dhe se ky Aktgjykim përmban titullin përmbarues, me të cilin kërkohet përmbushja e detyrimeve ndaj tij në cilësi të kreditorit, në njërën anë dhe në anën tjetër përmbushja e obligimeve të debitorit, në këtë rast NSH. Me Vendimin e saj AL, arsyetimin e saj e mbështet në regjistrin e punëtorëve të NSH dhe pagat e tyre gjersa nuk jep arsyetim mbi pjesën e arsyetimit pavarësisht ekzistimit të një Aktgjykimi. I njëjtë konsiderohet edhe arsyetimi në përgjigje ndaj kërkesës për rishikim-ankesës, kur nuk është dhënë asnjë argument lidhur me pohimet se në procedurë pranë AL nuk është parashtruar kopja e Aktgjykimit. Nga vetë fakti se paditësi ka parashtruar kopjen e padisë, AL është dashur të kërkoj nga paditësi apo të verifikoj pranë gjykatës lidhur me fatin e padisë dhe vendimin e gjykatës-Aktgjykimin.

Lidhur kompensimin, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit. Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: "kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë".

Nga dispozita e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse: Pagat e punonjësit, në këtë rast paditësit, nuk janë paguar. Marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i Vendimit të AKP, dhe Ndonjë veprimi tjetër nga ana e Agjencisë, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast paditësi ka ofruar arritur që të dëshmojë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e

vendimit/veprimet të AKP. Ky fakt i pakontestueshëm edhe nga AL.

Shkalla e parë ka arsyetuar se nga të gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se paditësi ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 respektivisht 1.7, të Shtojcës së Ligjit për AKP fakt ky i argumentuar me Aktgjykim.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kamatën ligjore, sipas pikës 3 (tre) të dispozitivit, vepron në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP, ku thuhet si në vijim: "të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore", andaj edhe vendosi si në dispozitiv.

Paditësi, nga formulari i kërkesave të parashtruar pranë AL, ndër tjerash shihet se ka kërkuar edhe shumën prej 78.00 (shtatë tetë) Euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve gjyqësore të shkaktuara në procedurën e zhvilluar pranë GJKL.

Këtë kërkesë të paditësit gjykata e konsideron si të pabazuar, për faktin se me Aktgjykim thuhet se kjo shumë nuk është e gjykuar dhe për më tepër nga dispozitivi i saj thuhet se secila palë i bartë shpenzimet e saj procedurale. Kjo nënkupton se si paditësi e po ashtu e NSH në cilësi të palëve ndërgjegjes, i bartin vetë shpenzimet e krijuara.

Me 11 maj 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS, një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS, C-IV-14-0241, të datës 26 prill 2023, AKP-ja e ka atakuar vendimin e shkallës së parë shkak të vlerësimit të gabuar të situatës faktike dhe Vlerësimit të Zbatimit të nenit 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe Nenit 608 të ligjit për punën e bashkuar nga Autoriteti i Likuidimit. AKP-ja kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit, dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në ankesë, AKP-ja ka pohuar se Gjykata e shkallës së parë është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se afatet janë ngatërruar nga Gjykata. Afati i parë është ai për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta realizojë në Gjykatë e që është afati i aplikueshëm i parashkrimit bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së

Bashkuar. Të dy këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe se të dy afatet duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në parashkrimin, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka të drejtën të parashtror kërkesën pranë AKP-së, dhe nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion.

Tutje AKP-ja e përsërit pretendimin e saj se kërkesa është parashtruar në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar. Në ankesë i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e shkallës së parë dhe të dytë të DHPGJS-së.

Me 28 qershor 2023, shkalla e dytë ka lëshuar Urdhër për paditësin i cili mund të parashtrorë përgjigje ndaj ankesës brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij Urdhri.

Më 22 korrik 2024, paditësi ka parashtruar kërkesë për përsheptim të lëndës, tutje ka shtuar që unë si punëtor Fabrikës së Letrës së Kartuçit dhe Ambalazhit në Lipjan dhe kërkon gjithsejtë borgjin e mbetur i pranuar nga Gjykata Komunale në Lipjan. Paditësi në këtë kërkesë të parashtruar pranë Kolegjit të Apelit ka kërkuar që ti ndihmohet të i gëzojë borgjin e mbetur, i njëjti ka pohuar se është në moshë të shtyrë 78 vjeç dhe dëshiron të i gëzojë sa është gjallë, po ashtu ka shtuar se të gjithë punëtoreve u janë paguar pagat e mbetura në përjashtim të tij.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së C-IV-14-0241 i datës 26 prill 2023, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi pranë Autoritetit të Likuidimit me datë 09 mars 2007 ka parashtruar kërkesat për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 2,354.00 euro për periudhën nga nëntori 2003 deri në Dhjetor 2004 dhe shpenzimeve gjyqësore në shumë prej 78.00 euro. Autoriteti i Likuidimit i ka pranuar shumën prej 911.05 euro si dhe shumën prej 95.90 euro, mbi tatimin në të Hyra Personale, shumë e cila i paguhet Administratës Tatimore të Kosovës, në emër dhe llogari të NSH-së ndërsa i është refuzuar shuma prej 1,473.00 euro si e pa bazuar.

Me 26 prill 2023, Shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-0241, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën/kërkesën e paditësit për rishikim të vendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ka shfuqizuar vendimin e AL PRN022-0017 të datës 11 dhjetor 2013, e obligon Autoritetin e Likuidimit – AKP-në që paditësit, në emër të kompensimit të pagave të papaguara, ti paguhet shuma prej 2,354.00 Euro si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % t'i paguhet shuma prej 235.40 Euro, ndërsa Kërkesën e paditësit me të cilën kërkon kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, të shkaktuara pranë Gjykatës Komunale në Lipjan, në shumë prej 78.00 Euro, e ka refuzuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e parë, kërkesën e tij për kompensim për paga të papaguara e ka mbështetur me prova të mjaftueshme, siç janë: Kopjen e padisë, e parashtruar në Gjykatën Komunale në Lipjan, me 23 dhjetor 2005, Kopja e Vërtetimit, nr. 2/2000 datë 15 prill 2005, lëshuar nga NSH, mbi pozitën e tij si i punësuar, Kopja e kërkesës kreditore, Kopja e Aktgjykimit, dhe Kopja e Aktvendimit, E.nr.553/2006 datë 27 dhjetor 2007 për pezullimin e procedurës së ekzekutimit të Aktgjykimit.

Me këto dëshmi paditësi, padyshim ka vërtetuar se ai kishte të drejtë që të i njihet pjesërisht e drejta e tij në kompensimin e pagave në shumën prej 2,354.00 Euro si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % t'i paguhet shuma prej 235.40 Euro.

Siç ka konstatuar edhe Shkalla e parë edhe Kolegji i Apelit vlerëson se e drejta e paditësit mbi pagat e pa-paguara buron nga Aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.2/2006 i dt. 17 korrik 2006, i cili ishte bërë i plotfuqishëm me dt. 18 shtator 2006 dhe si rrjedhojë në procesin e likuidimit është obligimi i

NSH që paditësit ti paguaj pagat e pa-paguara në shumë prej 2,354.00 euro, shumë kjo për periudhën e kërkuar. Gjithashtu është i saktë konstatimi i Shkallës së parë se ky aktgjykim përmban bazën ligjore që paditësit ti njihet kjo e drejtë tek AL.

Prandaj duke u bazuar në provat e bashkangjitura, Shkalla e parë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar ankesën e paditësit si pjesërisht të bazuar dhe e kishte shfuqizuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që vendimi i AL nuk mbështetej në dispozita ligjore.

Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e parë me rastin e vendosjes drejtë ka aplikuar nenin 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbusha e kërkesave siç janë: "kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë".

Kolegji i Apelit vëren se e paditura me ankesën e saj të paraqitur në Kolegjin e Apelit e ngrit edhe çështjen e parashkrimit të kërkesës së paditësit për paga. Kolegji i Apelit vëren se e paditura as në vendimin e saj tek AL dhe as në shkallën e parë të DHPGJS, ku vendimi i AL ka qen objekt shqyrtimi nuk është thirrur në parashkrim. Çështjen e parashkrimit tani e ngrit në kolegjin e Apelit, ku sipas mendimit të kolegjit të Apelit kjo çështje në procedure të shkallës së dytë nuk duhet të trajtohet meqë nuk është kundërshtuar as në procedurë tek AL dhe as në shkallën e parë. Megjithatë vërehet qarte se nuk ka parashkrim të kërkesës së paditësit për paga meqë që nga provat e prezantuara nga paditësi siç janë: Kopjen e padisë e parashtruar në Gjykatën Komunale në Lipjan, me 23 dhjetor 2005, Kopja e Aktgjykimit C.nr.2/2006 i dt. 17 korrik 2006, i cili ishte bërë i plotfuqishëm me dt. 18 shtator 2006, ku sipas nenit 379 të LMD-së së vjetër dhe 361 të LMD-së në fuqi, përcaktohen se të gjitha kërkesat detyrimore juridike të vërtetuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës nuk parashkruhen brenda afrit 10 vjeçar. E duke marr parasysh edhe Aktvendimin e Gjykatës E.nr.553/2006 datë 27 dhjetor 2007 për pezullimin e procedurës së ekzekutimit të Aktgjykimit, del që kërkesa e paditësit për paga nuk është parashkruar, e aq me tepër kur dihet se paditësi kërkesën për paga të papaguara tek AL e ka paraqitur me dt. 09 mars 2007, ende pa kaluar një vit nga dita e plotfuqishmëri se aktgjykimit me të cilin paditësit i ishin njohur pagat.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 14 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 17 tetor 2024

Mr. Sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____